



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	0MM
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No	4097-2/26
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	04
Data Datum Date	
31 / 08 / 2026	
PRISHTINE/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Departament za Zivotnu Sredinu/
Department of Environment Protection

DATË/A:	26.08.2026
REFERENC-Ë:	26/4097-588/DMM
PËR/ZA/TO:	"Bitter Farbwerke" Sh.p.k. Miradi e Epërme, Fushë Kosovë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Znj.Miradije Gërguri,U.D. Drejtore e DMM-së Z. Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLLM-së
NGA/OD/FROM:	Përparim Terziu, Zyrtar i Lartë i Angazhuar për Biocide
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën për Leje Importi për Produkte Biocide

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.4097/26, datë: 17.07.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Bitter Farbwerke" Sh.p.k. Miradi e Epërme, Fushë Kosovë dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/4097/MMPH
Datë: 26.08.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 27 paragrafi 1 dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, si dhe nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate, nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa me Nr.Prot.4097/26, datë: 17.07.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Bitter Farbwerke" Sh.p.k. Miradi e Epërme, Fushë Kosovë.

Lista e produkteve biocide për të cilat operatori ka bërë kërkesë për import shënuara në tabelën e mëposhtme, substanca aktive e produkteve në fjalë **nuk është e lejuar**, sipas verifikimit në ueb faqen e Agjencisë Evropiane e Kimikateve (ECHA - European Chemicals Agency)



Substanca aktive	Produkti	Sasia / forma	Nr. i notifikimit	Cas Numër	Lloji i produktit biocid (PT)
Terbutryn+2-Octyl-2H-isothiasol-3-one (OIT)	ACTICIDE MKT 1	100 KG / lëng koncentrat	5437/4097/26/KOS	886-50-0	PT 07 Konservues për filma / veshje Nuk është e lejuar
4,5-Dichloro-2-octyl-2H-isothiasol-3-one (DCOIT) + 2-Octyl-2H-isothiasol-3-one (OIT)	ACTICIDE MKN 9	100 KG / lëng koncentrat	5438/4097/26/KOS	64359-81-5	PT 07 Konservues për filma / Veshje Nuk është e lejuar

Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Importi për Produkteve Biocide të kompanisë "Bitter Farbwerke" Sh.p.k. Miradi e Epërme, Fushë Kosovë, me Certifikatë të Regjistrimit të Biznesit, NUI 810866494, Zyrtari i Lartë i Angazhuar për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Importi për Produkte Biocide, konstatoi se operatori **nuk i plotëson** kriteret e parapara sipas nenit 29 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate dhe nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate.

Substanca aktive e produkteve në fjalë nga tabela e më sipërme, **nuk është e lejuar** sipas verifikimit në ueb faqen e Agjencisë Evropiane e Kimikateve (ECHA- European Chemicals Agency), andaj MMPH, **refuzon** kërkesën për t'u pajisur me Leje Importi të Produkteve Biocide.


Pala ka paguar taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro për marrjen e Lejes për import për produkte biocide, siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligji Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat 30 ditë nga marrjes së këtij vendimi në Komisionin e ankesave për shqyrtimin e vendimeve lidhur me lejet në Ministri.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/4097/ZSP/ /26 datë: 26.08.2026



Bajram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së